**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 6372 Prot

Rrëshen më, 29. 12. 2025

# V E N D I M

**Nr. 103 datë 29. 12. 2025**
**PËR**
**"PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE",**
**BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", në Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 24.01.2025, "Për miratimin e buxhetit 2025", VKB nr. 115, datë 27.12.2024, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", *Kërkesën për financim nr. 5513 prot, datë 10.11.2025, relacionin nr. 5513/1 prot, datë 23.12.2025, "Mbi vlerësimin ekonomik - social të familjes të Znj. Vitore Mark Prenga", nga sektori i shërbimit social të bashkisë,* së bashku me projektin-vendimin e Kryetarit Bashkisë, *shqyrtimin e miratimin në mbledhjen e datës 29.12.2025, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit,* për t'a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

## V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, *në shumën **50 000** (pesëdhjetë mijë) lekë*, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;

- T'i akordojë ndihmë financiare, Znj. Vitore Mark Prenga me ID; G25825029A, qyteti Rrëshen, njësia administrative Rrëshen, për kushte të vështira jetese

   a. **Paksim:** Fondi rezervë; (A1133 00 2133001 01 V491AAA...604) në vlerën;.............**50 000** lekë

   b. **Shtohet:** Pagesë; (AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;.......................**50 000** lekë

2. Pagesa të kalojë me bordero, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave)

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!*

**S E K R E T A R**

**Gaspër TOPOLLAJ**

**K R Y E T A R**

**Aleksandër PICAKU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË -

ADRESA: SHESHI "ABAT DOCI" RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax: (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

**BASHKIA MIRDITË**

**Nr.5513/2 Prot.** **Rrëshen, më 23.12.2025**

**P/V E N D I M**

**Nr.116 datë 23.12.2025**

"PËR PËRDORIM FOND REZERVË"

Mbështetur në ligjin 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin Nr.68/2017 'Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin Nr.115/2024, 'Për buxhetin e vitit 2025" 'Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 'Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin Nr.2 datë 24.01.2025, 'Për zbatimin e buxhetit 2025", në VKB Nr.115 datë 27.12.2024 'Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", në kërkesën Nr.4252 Prot dt.11.11.2024, në relacionin Nr.5513/1 prot, datë 23.12.2025 e sektorit të shërbimit social të NJA Rrëshen, Bashkia Mirditë, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkisë:

V E N D O S I :

*I-Të miratojë përdorimin e fondit Rezervë në shumën 50 000 (Peswdhjetë mijë) lekë .) për dhënie ndihmë financiare si më poshtë*:

1.T'i akordojë ndihmë financiare, Znj.Vitore Mark Prenga për kushte të vështira jetese me ID G25825029A , banuese në Njësinë Adm.Rrëshen.

a-Paksim : Fondi rezervë ( AII33 00 2133001 01 V491AAA.604) për shumën 50 000 lekë

b-Shtohet;( AA133 00 2133001 01 V111AAA…..606) për shumën …… …….50 000 lekë

2.Pagesa të kalojë në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen.

*II-* Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari I Bashkisë (Drej.Zhv.Ek.Tat.Taksave).

*III-*Ky vendim hyn në fuqi 10 ( dhjetë ) ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI** **KRYETARI**

**Gaspër TOPOLLAJ** **Aleksandër PICAKU**

**Paraqitën projektin**

Dr/zhvill ek dhe tatim taksat: V.Gjoka

Përgj.sek.juridik & prokurimeve M.Topollaj

**KRYETARI**
**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel&fax :+3552162223web web:www.bashkiamirdite.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
SEKRETARIA

Nr. 5513 prot
Dt. 10.11.2025

**KËRKESË**
**Drejtuar:** Këshillit Bashkiak Mirditë
**Në vëmendje të:** Kryetarit të Bashkisë, Z. Albert Melyshi

Unë, **Vitore Mark Prenga**, me nr. ID G25825029A, banuese në qytetin e Rrëshenit, ju paraqes këtë kërkesë për ndihmë financiare.

Prej vitit **2010** vuaj nga një sëmundje e rëndë e veshkave dhe trajtohem me **hemodializë tre herë në javë**. Së fundmi, në **17.07.2025**, jam **operuar për tiroide** pranë spitalit **"Zoja e Këshillit të Mirë"** në Tiranë, pasi ndërhyrja nuk mund të kryhej pranë spitalit **QSUT** për shkak të gjendjes sime shëndetësore të rënduar.

Për kryerjen e këtij operacioni kam shpenzuar shumën prej **300 000 lekësh**, sipas **faturës nr. 21743/REG_OSP dhe faturës nr. 21653/REG_OSP**.
Duke qenë se gjendja ime ekonomike është e vështirë dhe e ardhura e vetme është trajtimi invalidor, ju **lutem të më trajtoni me një ndihmë financiare** për të përballuar një pjesë të shpenzimeve mjekësore.

Me respekt,
**Vitore Mark Prenga**
Tel.:0686279353
Tel.:0686462740

Financa

BASHKIA MIRDITË

AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE

Nr.5513/1 Prot. Rrëshen, më 23.12.2025

**Lënda:** Kërkesë për mbështetje financiare

**Drejtuar:** Drejtorisë së Financës

Lidhur me kërkesën e ardhur në Bashkinë Mirditë më 10.11.2025, me nr. 5513 Prot, drejtuar nga zj. Vitore Mark Prenga, e lindur në Shëngjergj më 25.08.1962, me NID G25825029A për ndihmë financiare për çështje shëndetësore, ju japim relacionin si më poshtë:

Zj. Vitore Mark Prenga është banuese në Rrëshen, ajo figuron në certifikatë me bashkëshortin dhe tri vajzat, por me bashkëshortin është e ndarë. Zonja është e pajisur me status invaliditeti dhe përfiton shumën prej 22 000 lekë të reja në muaj. Të ardhura të tjera vijnë nga ndihma ekonomike, ku përfiton shumën prej 3000 lekë të reja në muaj.

Problemi më shqetësues për zonjën në fjalë është gjendja shëndetësore, ku prej vitit 2010 ajo vuan nga azotemia në veshka dhe trajtohet tre herë në javë me homodializë. Kohëve të fundit, konkretisht më 17.07.2025 është operuar në "Spitalin Zoja e Këshillit të Mirë" në Tiranë për tiroiden, pasi për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore, ndërhyrja nuk mund të realizohej nga QSUT. Kjo ndërhyrje ka arritur vlerën e 300 000 lekë të reja, siç e dëshmon edhe fatura me nr.21743/REG_OSP dhe fatura me nr.21653/REG_OSP.

Si Shërbim Social, duke e njohur tashmë rastin nga afër dhe duke ditur shpenzimet që nevojiten për trajtim dhe kurim, e vlerësojmë të nevojshme dhënien e një mbështetjeje financiare për zonjën në fjalë.

Konceptoi: Adela Gjikola

Miratoi: Drejtori Aurel Çupi

Përgjegjës i Sekt.Soc. Gjergj Përgjoni